



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**

**K.P.P. 870/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 24.12.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Alpha Solution Group” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr.REF-93369-11-08-2018 me objekt: “*Materiale të ndryshme hidraulike*”, me fond limit 2 200 000 lek pa tvsh, zhvilluar në datën 19.11.2018 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd. Gjithashtu kërkohet anulimi i procedurës së prokurimit.”

**Ankimues:**

“Comfort” sh.p.k  
Rr. “Manol Konomi”, Nd.14, H6/1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd  
Sheshi i Angjesise Librazhd

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.11.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-93369-11-08-2018 me objekt: “*Materiale te ndryshme hidraulike*”, me fond limit 2 200 000 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 19.11.2018 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd.

II.2. Në datën 19.11.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit kanë dorëzuar mostrat e materialeve hidraulike, objekt prokurimi, në ambientet e autoritetit kontraktor.

II.3. Në datën 21.11.2018 ofertuesit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe shoqëritë e skualifikuar si më poshtë:

- |                                   |                              |
|-----------------------------------|------------------------------|
| 1. “Comfort” sh.p.k               | 1.959.549 lekë, skualifikuar |
| 2. “Alpha Solutions Group” sh.p.k | 2.180.020 lekë, kualifikuar  |
| 3. “Fat Group” sh.p.k             | 2.193.175 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi: [...]

1. Nuk është dorëzuar deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme.
2. Nuk është dorëzuar deklarata mbi konfliktin e interesit.
3. Nuk janë paraqitur mostra për të gjithë artikujt e preventivit, janë paraqitur 17 nga 48 të tilla për të vërtetuar se përmbushin specifikimet teknike.”

II.3. Në datën 22.11.2018 operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si dhe duke

ngritur pretendime lidhur me mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” sh.p.k dhe procesin e dorëzimit të tyre.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 11/7 prot., datë 26.11.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën. Konkretisht janë pranuar pretendimet e ankimuesit përse i përket arsyes së parë dhe të dytë të skualifikimit të tij dhe nuk janë pranuar pretendimet e tjera.

II.6. Në datën 04.12.2018 operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar skualifikimin e shoqërisë “Alpha Solutions Group” sh.p.k pasi nuk ka paraqitur të gjitha mostrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor si dhe anulimin e procedurës së prokurimit.

II.7. Në datën 19.12.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1833/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 11/9 prot., datë 17.12.2018, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Comfort” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 21.11.2018 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave skualifikimin e tij si më poshtë:

- |                                   |                              |
|-----------------------------------|------------------------------|
| 1. “Comfort” sh.p.k               | 1.959.549 lekë, skualifikuar |
| 2. “Alpha Solutions Group” sh.p.k | 2.180.020 lekë, kualifikuar  |
| 3. “Fat Group” sh.p.k             | 2.193.175 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k është skualifikuar pasi: [...]

1. Nuk është dorëzuar deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.
2. Nuk është dorëzuar deklarata mbi konfliktin e interesit.
3. Nuk janë paraqitur mostra për të gjithë artikujt e preventivit, janë paraqitur 17 nga 48 të tilla për të vërtetuar se përmbushin specifikimet teknike.”

III.1.2. Në datën 22.11.2018 operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si dhe duke

ngritur pretendime lidhur me operatorin ekonomik “Alpha Solutions Group” sh.p.k. Autoriteti kontraktor, pas shqyrtimit të ankesës, ka vendosur të pranojë pretendimet e ankimesit përse i përket arsyeve të skualifikimit të shoqërisë ankimese se nuk janë dorëzuar deklaratat mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe konfliktin e interesit. Shoqëria “Comfort” sh.p.k vijon të mbetet i skualifikuar në SPE për arsye se nuk ka paraqitur mostra për të gjithë artikujt e preventivit, pasi janë paraqitur 17 nga 48 të tilla, për të vërtetuar se përmbushin specifikimet teknike.

III.1.3. Nga verifikimi i kryer në SPE rezulton se në datën 27.11.2018 ankimesi është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij pasi:

*“...Nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kerkeseve per kualifikim sic kerkohen ne shtojcat e DT. Operatori nuk ka arritur te plotesoje Kriterin e Vecante te Kualifikimit nr.2.3.5 ku eshte kerkuar: 2.3.5 Operatori ekonomik, në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave që ofron, që duhet të përmbushin specifikimet teknike. Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim. Dorezimi i mostrave nga ana e operatorit ekonomik do te shoqerohet me vertetim te leshuar nga AK mbi dorezimin e mostrave. Per operatoret te cilet nuk do te rezultojne te suksesshem per kete procedure prokurimi mostrat brenda 30 diteve. Ne ditën e hapjes se tenderit OE “COMFORT” shpk eshte paraqitur prane zyrove te Autoritetit Kontraktor dhe ka arritur te paraqese 17 (shtatembedhjete) mostra te mallrave qe ofron. Ne preventivin e paraqitur ne tender AK ka kerkuar blerjen e 48 (dyzet e tete) mallrave te ndryshem me specifikime teknike perkatese. Per kete OE u informua se ka arritur te paraqese vetem 17 mostra dhe u pajis dhe me vertetimin nr.11/19.1 , ku u specifikua se OE ka paraqitur vetem 17 mostra te mallrave. Kjo gje eshte ne kundërshtim me kriterin nr.2.3.5 te kerkuar, pasi ne DST eshte kerkuar qe OE ne momentin e hapjes se ofertave duhet te paraqese mostra te mallrave qe ofron qe duhet te permbushin specifikimet teknike. Ky kriter nuk eshte plotesuar nga OE “COMFORT” shpk dhe mosdorëzimi i mostrave ne momentin e hapjes se ofertave eshte kusht per skualifikim. Persa me siper OE “COMFORT” shpk nuk ka arritur te permbushë kete kriter kualifikimi duke mosparaqitur te gjitha mostrat e kerkuara, per te vertetuar se permbushin specifikimet teknike. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”; Ne shtojca 11 e DT parashikohet se...Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Ne kete rast KVO eshte e detyruar te zbatoje percaktimet e nenit 55/2 te LPP, pra te vleresojë permbushjen e cdo kriteri per kualifikim qe gjendet ne DT . Ligji nuk i jep mundesi KVO qe sipas rastit apo sipas operateve pjesemarres , nje kriter per kualifikim ta marre ne konsiderate e ndonej kriter te mos e marre ne konsiderate Ne te kundert do te vepronet ne kundërshtim me parimet e transparences , barazise dhe trajtimit te barabarte te ofertuesve pjesemarres ne kete procedure prokurimi. Në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe*

*specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... Persa me sipër, KVO vendos skualifikimin e operatorit ekonomik “COMFORT” sh.p.k..”*

III.1.4. Në datën 04.12.2018 operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar skualifikimin e shoqërisë “Alpha Solutions Group” sh.p.k pasi nuk ka paraqitur të gjitha mostrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor si dhe anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.5. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

*“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k vijon të mbetet i skualifikuar në bazë të vendimit të autoritetit kontraktor, dhe nuk kundërshton në KPP arsyen e skualifikimit për mosparaqitjen e të gjitha mostrave nga ana e tij. Në këto kushte trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me operatorin ekonomik “Alpha Solutions Group” sh.p.k pjesëmarrës në procedurë, e për pasojë dhe kërkesa e tij për anulimin e procedurës së prokurimit, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe këto pretendime nuk do merren në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët se operatori për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për këtë operator me ofertë më të madhe, referuar vlerës ekonomike. Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me operatorin ekonomik “Alpha Solutions Group” sh.p.k nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Comfort” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-93369-11-08-2018 me objekt: “*Materiale te ndryshme hidraulike*”, me fond limit 2 200 000 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 19.11.2018 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1833 Protokoli,**

**Datë 04.12.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**